

Termat e Referencës: “Ekspert për realizimin e një studimi për zonat e eroduara në Parkun Kombëtar të Shebenikut-PKSH”, për AdZM Elbasan, aktiviteti 2.1

1. Hyrje

Parku Kombëtar i Shebenikut-PKSH është një zonë me vlera të larta ekologjike dhe biodiversitet të pasur. Megjithatë, për shkak të faktorëve natyrorë dhe antropogjenë, erosi i tokës është një sfidë e rëndësishme për menaxhimin e qëndrueshëm të parkut (PKSH). Humbja e sipërfaqeve të tokës, degradimi i habitateve dhe ndikimi në burimet ujore e bëjnë të domosdoshme një studim të detajuar për zonat e eroduara në PKSH, në mënyrë që të propozohen masa efektive për restaurimin dhe mbrojtjen e tyre.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH (PA_026), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon një ekspert për realizimin e një studimi për zonat e eroduara në Parkun Kombëtar të Shebenikut-PKSH.

Ky studim do të ndihmojë Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Elbasan dhe institucionet e tjera përgjegjëse në vlerësimin e gjendjes aktuale dhe në hartimin e strategjive të përshtatshme për menaxhimin e tokave të prekura nga erozioni.

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a) Të realizojë një studim të detajuar mbi zonat e eroduara në Parkun Kombëtar të Shebenikut-PKSH, duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në erozion dhe duke propozuar masa të qëndrueshme për reduktimin dhe rehabilitimin e tyre.
- b) Studimi do të shërbejë për Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Elbasan dhe institucionet e tjera përgjegjëse si një bazë shkencore dhe teknike për vlerësimin e gjendjes aktuale, planifikimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes nga erozioni dhe menaxhimin e burimeve natyrore në park si dhe të tokave të prekura nga erozioni në PKSH.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Kombëtar Shebenik-PKSH sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për realizimin e një studimi për zonat e eroduara në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH” për AdZM Elbasan lidhur me PKSH.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për raportin që do të hartojë:

- *Analizë të situatës aktuale:* Vlerësim i shkallës së erozionit në park (PKSH), përfshirë faktorët natyrorë (hidrologjikë, topografikë, klimatikë) dhe antropogjenë (shpyllëzimi, ndërtimet, bujqësia).
- *Identifikim i zonave më të prekura nga erozioni:* Identifikimi duke emërtuar se cilat janë zonat më problematike për erozion në PKSH.
- *Vlerësim i ndikimeve ekologjike dhe socio-ekonomike:* Analizë e ndikimit të erozionit në biodiversitet, habitate dhe burimet ujore, si dhe në jetesën e komuniteteve përreth PKSH.
- *Rekomandime për masat e menaxhimit:* Propozime për masa parandaluese dhe restauruese për erozion, si pyllëzimi, teknika të mbajtjes së ujit, ndryshime në praktikën e përdorimit të tokës dhe metodat e kontrollit të erozionit në park (PKSH).
- *Strategji për monitorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm:* Propozim për një plan afatgjatë për monitorimin e erozionit dhe integrimin e masave të mbrojtjes në politikat e menaxhimit të parkut (PKSH).
- *Produkti final (Raport studimi i detajuar) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Ekspteri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkencë mjedisore, inxhinieri pyjore, gjeografi, menaxhim të burimeve natyrore ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë të paktën 5-vjeçare në studime të ngjashme.
- Njohuri të mira mbi kuadrin ligjor për menaxhimin e tokës dhe biodiversitetin në Shqipëri dhe BE.
- Eksperiencë në bashkëpunimin me institucione dhe komunitete lokale për menaxhimin e burimeve natyrore.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për realizimin e një studimi për zonat e eroduara në Parkun Kombëtar të Shebenikut-PKSH” për AdZM Elbasan lidhur me PKSH.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKP, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 2.1 me objekt "Ekspert për realizimin e një studimi për zonat e eroduara në Parkun Kombëtar të Shebenikut-PKSH" për AdZM Elbasan lidhur me PKSH,

parashikuar në vlerën maksimale 5,000 (pesë mijë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).